



Tiranë më

Nr.

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 11, DATË 1.11.2024, TË KOMISIONIT RREGULLATOR “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË DOKUMENTACIONIT QË KËRKOHEP PËR TË VËRTETUAR QËNDRIMIN E ZGJEDHËSIT SHQIPTAR QË VOTON JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, ME QËLLIM REGJISTRIMIN NË LISTËN E ZGJEDHËSVE JASHTË VENDIT”

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “dh”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcaktohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit, për procedurat e tyre të votimit, për administrimin dhe numërimin e votave nga jashtë vendit dhe përfshirjen e tyre në rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve për Kuvendin.

Neni 25, pika 5 përcakton se zgjedhësi që dëshiron të votojë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pas hapjes së procesit të regjistrimit nga KQZ-ja aplikon në mënyrë individuale për regjistrim në listën e këtyre zgjedhësve. KQZ-ja krijon, mirëmban dhe përditëson platformën elektronike për regjistrimin e kërkesave të zgjedhësve që dëshirojnë të votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Zgjedhësi për regjistrim në listë paraqet dokumentacion që vërteton qëndrimin e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Lista e detajuar e dokumentacionit që kërkohet për regjistrimin e zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë përcaktohet me vendim të Rregullatorit.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionit Rregullator për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Në datën 1.11.2024, Komisioni Rregullator miratoi vendimin “Për miratimin e listës së dokumentacionit që kërkohet për të vërtetuar qëndrimin e zgjedhësit shqiptar që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim regjistrimin në listën e zgjedhësve jashtë vendit”, me qëllim përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave që mundësojnë votimin nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvend.

Procesi i regjistrimit të votuesve nga jashtë për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025 ka vijuar me intesitet të lartë. Për të adresuar sfidat aktuale dhe me synimin përmirësimin dhe lehtësimin e procesit të regjistrimit të votuesve nga jashtë vendit, lind nevoja të bëhen disa ndryshime në vendimin 11, datë 1.11.2024.

- Propozojmë që pas pikës 1, shkronjës “k” të Kreut II, të shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

Dokumenti i cili vërteton qëndrimin e zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë mund të ngarkohet në PER nga çdo anëtar i familjes së personit në emër të të cilit është dokumenti. Në këtë rast personi që ngarkon dokumentin e adresës në PER duhet të ngarkojë sëbashku me të një nga dokumentet vijuese:

- a) certifikatë familjare të personit që aplikon në PER e cila tregon lidhjen ;*
- b) certifikatë personale e cila tregon lidhjen me personin në emër të të cilit është dokumenti i adresës;*
- c) një nga dokumentet shqiptare të identitetit të personit në emër të të cilit është dokumenti i adresës;*
- d) një deklaratë në format zyrtar të lëshuar nga personi në emër të të cilit është dokumenti i adresës.*

- Pas pikës 2 të shtuar, të shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

Dokumenti i adresës në emër të një personi mund të ngarkohet në PER edhe nga persona të tjerë të cilët banojnë në të njëjtën adresë me personin në emër të të cilit është ky dokument. Në këtë rast:

- a) personi në emër të të cilit është dokumenti i adresës duhet të lëshojë një deklaratë të vërtetuar nga një autoritet zyrtar sipas të cilës pranohet se edhe personi tjetër banon në të njëjtën adresë me të. Kjo deklaratë ngarkohet në PER nga ky i fundit gjatë procesit të aplikimit për t’u regjistruar në këtë platformë. Ose,*
- b) personi që ka interesin për të përdorur dokumentin e adresës i cili është në emër të personit bashkëjetues me të parin, duhet të ngarkojë në PER një nga dokumentet shqiptare të identitetit të personit në emër të të cilit është dokumenti i adresës shoqëruar me një deklaratë të thjeshtë me shkrim të këtij të fundit.*

- Pika 2 e Kreut II bëhet pika 4.

Për sa më lart në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i propozon për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator projektvendimin “Për miratimin e listës së dokumentacionit që kërkohet për të vërtetuar qëndrimin e zgjedhësit shqiptar që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim regjistrimin në listën e zgjedhësve jashtë vendit”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Kopje: 3

Afati i ruajtjes: 5 vjet

Punoi:

P.Doçaj _____

M.Çelmeta _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Tiranë më

protdate

Nr.

protnumber

Data: DD MM VVVV

Nr:000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 11, DATË 1.11.2024, TË
KOMISIONIT RREGULLATOR “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
DOKUMENTACIONIT QË KËRKOHEP PËR TË VËRTETUAR QËNDRIMIN E
ZGJEDHËSIT SHQIPTAR QË VOTON JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, ME QËLLIM REGJISTRIMIN NË LISTËN E ZGJEDHËSVE JASHTË
VENDIT”**

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “dh”, nenit 25, pika 5 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

VENDOSI:

Në vendimin nr. 11, datë 1.11.2024, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e listës së dokumentacionit që kërkohet për të vërtetuar qëndrimin e zgjedhësit shqiptar që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim regjistrimin në listën e zgjedhësve jashtë vendit”, bëhen këto ndryshime:

- Pas pikës 1, shkronjës “h”, të Kreut II, shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

“2. Dokumenti i cili vërteton provon adresën e deklaruar qëndrimin e zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë mund të ngarkohet në PER nga çdo anëtar i familjes së personit në emër të të cilit është dokumenti. Në këtë rast personi që ngarkon dokumentin e adresës në PER ngarkon së bashku me të edhe një nga dokumentet vijuese:

Data: dd mmvvvv Nr: 123-456

Ora: hh:mm



“Për disa ndryshime në vendimin nr. 11, datë 1.11.2024, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e listës së dokumentacionit që kërkohet për të vërtetuar qëndrimin e zgjedhësit shqiptar që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim regjistrimin në listën e zgjedhësve jashtë vendit”

- a) certifikatë familjare të personit që aplikon në PER, e cila tregon lidhjen me personin në emër të të cilit është dokumenti i adresës;
- b) certifikatë personale e personit që aplikon në PER, e cila tregon lidhjen me personin në emër të të cilit është dokumenti i adresës;
- c) një nga dokumentet shqiptare të identitetit të personit në emër të të cilit është dokumenti i adresës;
- ç) një deklaratë të lëshuar nga personi në emër të të cilit është dokumenti i adresës.”.

2. Pas pikës 2 të shtuar, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

Dokumenti i adresës në emër të një personi mund të ngarkohet në PER edhe nga persona të tjerë të cilët banojnë në të njëjtën adresë me personin në emër të të cilit është ky dokument. Në këtë rast personi në emër të të cilit është dokumenti i adresës duhet të lëshojë një deklaratë sipas të cilës deklaron se aplikuesi është banues në të njëjtën adresë me të. Në këtë rast aplikuesi duhet të ngarkojë në sistem këtë deklaratë bashkë me dokumentin e identifikimit të personit në emër të të cilit është dokumenti i adresës.

- 3. Pika 2 e Kreut II bëhet pika 4.
- 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, brenda (5) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Ilirjana NANO Kryetar

Arens ÇELA Anëtar

Dritan ÇAKA Anëtar

Helga VUKAJ Anëtar

Muharrem ÇAKAJ Anëtar